



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

# RAPORTI VJETOR I PUNËS

JANAR-DHJETOR 2021

# 2021

 REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA   
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Zar. i Mjesit  
Odojtarje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredino

-XII- N. i prot. 89 Më 06.04 22  
Bf. prot. 03 Dt. 03  
RAHOVEC - ORAHOVAC

# RAPORTI VJETOR I PUNËS

## DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për realizimin e punëve të planifikuara bartë mbi vete detyra në sektorin e planifikimit hapësinor dhe sektorin e projekteve, duke filluar me hartimin e projekteve zhvillimore, lejeve ndërtimore si dhe realizimin e projekteve kapitale. Në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë të drejtorisë paraqesim raportin vjetor të punës për vitin 2021 sipas sektorit për Planifikim Urban dhe sektorit për Mbrojtje të Mjedisit.

### Sektor i Urbanizmit dhe Planifikimit

Gjatë kësaj periudhe raportuese zyrtarët e DUPMM-së, nga sektori për Planifikim Urban janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim urban të qëndrueshëm. Procesi i trajtimit të objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit është duke vazhduar, janë pranuar kërkesa të shumta nga qytetarët për t'i legalizuar objektet e tyre, lëndët po shqyrtohen me kujdes, disa prej kërkesave janë futur në listën e pritjes për legalizim, pasi kështu është përcaktuar me ligjin për trajtimin e objekteve pa leje, pasi këto objekte janë të ndërtuara në tokë jo-ndërtimore apo për arsye tjera që përcaktojnë futjen në listën e pritjes, ndërkaq janë legalizuar objektet që i kanë plotësuar dhe i kanë përmbushur të gjitha kriteret për legalizim. Poashtu, bashkë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientet dhe me përkrahjen e USAID, kemi nisur procesin për legalizimin e shtëpive dhe objekteve, sipas Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje. Me këtë nismë do të trajtohen të gjitha objektet që janë ndërtuar apo kanë nisur të ndërtohen deri më 5 shtator, 2018 kur ligji ka hyrë në fuqi. Do të legalizohen shtëpitë e banimit, por edhe të gjitha objektet tjera që hyjnë në kategori të veçanta.

### Sektor i Mjedisit

Në kuadër të sektorit të mjedisit shqyrtohen kërkesat nga qytetarët për Leje Mjedisore Komunale si dhe kryhen aktivitete të tjera rreth mbrojtjes së mjedisit. Gjatë periudhës janar – dhjetor, në këtë sektor janë lëshuar - Leje Mjedisore Komunale dhe janë realizuar të hyra.

Kanë përfunduar debatet publike për prezantimin e draftit të parë të Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit, që përbën një hap të rëndësishëm për planifikimin dhe rregullimin e kushteve për zhvillim hapësinor. Përmes zonimit do të mundësohet që komuna të rregullojë shfrytëzimin dhe zhvillimin e tokës për tërë territorin e komunës sonë. Kjo nënkupton rregullimin e resurseve dhe mjedisit, infrastrukturës dhe shërbimeve përcjellëse, me synim të sigurimit të zhvillimit hapësinor, fizik, ekonomik, social dhe mjedisor,

## RAPORTI VJETOR I PUNËS

shëndetit, si dhe mirëqenies së komuniteteve në pjesë urbane dhe rurale. Në mënyrë që dokumenti i HZK-se të jetë i qasshëm për të gjithë qytetarët e komunës, pjesa tekstuale dhe hartografike ka qëndruar i ekspozuar në uebfaqen zyrtare të komunës së Rahovecit. Në të njëjtën kohë janë mbajtur edhe 7 takime në bashkësitë lokale, duke ju sqaruar më detajisht të gjithë banorëve të atyre vendbanimeve përmbajtjen dhe rëndësinë e HZK-së.

### Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Ka përfunduar rregullimi i shtratit të përroskës në Optrushë, një projekt i nisur në shtatorin e vitit të kaluar dhe i bashkëfinancuar nga Komuna e Rahovecit dhe MAPL, si nevojë infrastrukturore e fshatit për të evituar vërshimet e shpeshta që shkaktoheshin kur kishte të reshura të dendura;
- Pas përfundimit të punimeve në Optrushë, jemi afër përfundimit të punimeve në përroskën e fshatit Pataqan të Poshtëm;
- Në Malësi të Vogël po vazhdon puna për trajtimin e përroskave në këtë fshat, në total 3 kilometra. Me këtë projekt synohet evitimi i përmytjeve nga të reshurat e shumta, që jo rrallëherë u kanë kushtuar shumë banorëve të fshatit, si në sektorin e bujqësisë ashtu edhe në sektorin e amvisërisë;
- Në Ditën e Çlirimit të Rahovecit, përuam shtatorët e heronjve të kombit Bedrush dhe Feim Gashi, të cilët ranë në luftën për lirinë e Kosovës.
- Me rastin e ditëlindjes së veprimtarit dhe mendimtarit të shquar shqiptar nga Krusha e Rahovecit, kemi vënë gurthemelin e Kompleksit Muzeor "Ukshin Hoti", pranë shtëpisë muze të Ukshin Hotit. Projekti i kompleksit muzeor është dizajnuar dhe planifikuar të mos e pengojë fizikisht e as konceptualisht shtëpinë muze, përkundrazi e plotëson dhe e bën më të qartë fotografinë e personalitetit të Ukshin Hotit.
- Ndërtimi i parqeve në komunën e Rahovecit po vazhdon në: Xërxë, Pataqan i Epërm, Drenoc, Kramovik, Guri i Kuq, Çifllak, Brestoc, së shpejti edhe në Krushë e Madhe, parkingje në Ratkoc;
- Ka përfunduar projekti: Ndërtimi i kullës prej guri për heronjtë Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi– Mici dhe bashkëluftëraëve të tyre nga Vushtrria, te vendi i rënies mbi fshatin Operushë, është bërë edhe përrurimi;
- Drunjat dekorativ janë mbjellur në: Qytetin e Rahovecit, në hyrje-dalje të Rahovecit, në Drenoc, Polluzhë, Kramovik, Guri i Kuq, Mrasor, Çifllak, Dejnë, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhë, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Brestoc, Optrushë, Zaqisht, Pataqan të Poshtëm dhe Sapniq. Ata drunj që kanë dështuar, do të zëvendësohen;
- Komuna e Rahovecit momentalisht është duke investuar në trajtimin e shtretërve të lumenjeve në Krushë të Madhe, i financuar nga Komuna. Në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogel dhe Nagac, financuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Probleme me shtretër të përroskave kemi në fshatrat Dejnë, Ratkoc, Celinë, Sapniq, Gexhë, një përroskë e vogël në Brestoc, pjesën e poshtë të lumit Duhillo në Rahovec e përroska tjera të vogla, të cilat do t'i trajtojmë me një kontratë tjetër;

## RAPORTI VJETOR I PUNËS

- Po trajtohen të gjitha lapidaret, vendrëniet e dëshmorëve, pllakat përkujtimore, plato të shtatoreve të heronjëve dhe busteve të dëshmorëve;
- Po rinovohen komplet varrezat e martirëve ne Celinë, financuar nga Komuna e Rahovecit;
- Kanë përfunduar punimet në projektin e rregullimit të rrugëve me gurë ne pjesën e vjetër të Qytetit;
- Ndërtimi i Kompleksit Memorial në fshatin Retijë – Punimet janë duke vazhduar;
- Ndërtimi i shtratit të përroit në lagjen Kelmendi në Kramovik – Punimet janë duke vazhduar;
- Rregullimi i varrezave të dëshmorëve, martirëve dhe civilëve - Punimet janë duke vazhduar;
- Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit – Jemi në proces të lidhjes së kontratës;
- Vazhdimi i rregullimit të lumit Rimnik në Fortesë - Punimet janë duke vazhduar.

Drejtori Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Rumir Zhuniqi

